



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 19 mars 2014, në mbledhjen konstituive të Komitetit për komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama, z. Radisav Perović, z. Shaban Ahmeti, z. Shaban Osmani, Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Fadil Babatinca, Stacioni i Policisë në Podujevë, z. Bekim Karaxhija, OSBE dhe Norbert Bulejka, LMT

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi propozuar i ditës u miratua njëzëri

2. Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Komitetit për Komunitete

Fillimisht z. **Mehmet Gashi**, kryesues i Kuvendit, rikujtoi se kryesuesi i këtij Komiteti duhet të jetë pjesëtar i komuniteteve pakicë.

z. **Shaban Osmani**, për kryesues të Komitetit për Komunitete propozoi z. Shaban Ahmetin duke arsyetuar se i përmenduri ka përvojë në punët dhe aktivitetet e këtij Komiteti.

z. **Mefail Rama**, e propozoi z. Xhafer Ademin duke e arsyetuar se propozimin e tij e mbështet në ndryshimet e nevojshme që duhet bërë në punët dhe aktivitetet re këtij Komiteti.

z. **Radisav Perović**, e propozoi z. Shaban Ahmetin.

z. **Mehmet Gashi**, kryesues i Kuvendit, theksoi, duke u bazuar se së pari për kryesues të Komitetit për Komunitete u propozua z. Shaban Ahmeti, propozim i cili u mbështet edhe nga një anëtar tjetër i këtij Komitete, fillimisht e vejë në vota këtë propozim.

Pas votimit u konstatua se z. Shaban Ahmeti, me 5 vota për dhe 2 vota kundër u zgjedh kryesues i Komitetit për Komunitete.

z. Shaban Ahmeti, kryesues i porsazgjedhur, e kryesoi vazhdimin e mbledhjes dhe fillimisht u falënderua për besimin e dhënë, nënvizoi se është i vetëdijshëm për përgjegjësin e tij në cilësinë e kryesuesit por edhe të anëtarëve të këtij Komiteti dhe shprehu gatishmërinë për angazhim të përbashkët në zgjidhjen e të gjitha shqetësimeve të qytetarëve dhe çështjeve që shtrohen për shqyrtim në këtë Komitet.

z. Xhevdet Beselica, për zëvendëskryesues të këtij Komiteti e propozoi z. Shaban Osmanin.
Ky propozim u miratua njëzëri.

Në vazhdim, **z. Xhafer Ademi**, theksoi, subjekti politik të cilit unë i përkas në zgjedhjet e fundit lokale i ka fituar shumicën e votave dhe ne synojmë të bëjmë ndryshime, andaj konsideroj se me zgjedhjen e z. Shaban Ahmetit për kryesues të këtij Komiteti do të kemi vështirësi t'i bëjmë ndryshimet e planifikuara dhe duke u bazuar në këtë unë deklaroj se tërhiqem nga cilësia e anëtarit të Komitetit për Komunitetet, përndryshe kjo është edhe kërkesë e komunitetit të cilin e përfaqësoj. Në fund nënvizoi, sot pas kësaj mbledhjeje apo më së largu deri ditën e nesërme, në formë të shkruar, do të tërhiqem nga anëtarësia e këtij Komiteti.

z. Mefail Rama, theksoi, i bashkëngjitëm zotëri Xhafer Ademit dhe shtoi, jemi në dijeni se përgjegjësia e Komitetit për Komunitete është që t'i mbrojtë të drejtat e të gjitha komuniteteve pakicë dhe konsideroj se në këtë aspekt Komiteti për Komunitete, deri më tani, nuk ka punuar mjaftë e në veçanti nuk jam i kënaqur me punën dhe angazhimin e z. Shaban Ahmetit i cili ka qenë kryesues i këtij Komiteti edhe në mandate të tjera, ngase nuk i ka marr parasysh kërkesat e komunitetit tim.

z. Shaban Ahmeti, kryesues, Komiteti për Komunitete i komunës tonë deri tash gjithherë ka qenë unik dhe është dalluar për punën dhe angazhimin e vet.

z. Xhafer Ademi, parafolësit iu përgjigj, nuk them se nuk është punuar fare por po e përsëris, ky Komitet ka nevojë për ndryshime në punën dhe angazhimin e vet.

z. Shaban Osmani, theksoi, duhet ta kemi të qartë një çështje se kryesuesi i këtij Komiteti është i pari në mesin e të barabartëve, nuk ka asnjë privilegje më tepër se ne, ai vetëm e udhëheq mbledhjen dhe asgjë tjetër. Sa i përket asaj se a do të jetë i suksesshëm apo jo ky Komitetet, kjo nuk varet vetëm nga angazhimi i kryesuesit por varet nga puna dhe angazhimi i të gjithë neve.

z. Xhevdet Beselica, theksoi, procesi i propozimit dhe i votimit për kryesues të këtij Komiteti ishte mjaftë demokratik andaj konsideroj se janë shumë të paarsyeshme çfarëdo kundërshtimesh në këtë aspekt.

Përndryshe ne bashkërisht do të vendosim për të gjitha çështjet që janë në kompetencë të këtij Komiteti dhe nëse z. Shaban Ahmeti, në të ardhmen nuk angazhohet dhe nuk i bindet vullnetit të shumicës, atëherë sigurisht se mund ta shtrojmë mocionin e votëbesimit dhe mund ta shkarkojmë nga kryesuesi i këtij Komiteti.

z. Liman Zeqiri, theksoi, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim të gjitha kërkesat të cilat i janë adresuar i ka përcjellë në Komitetin për Komunitete dhe në mundësitë tona kemi pasur trajtim të sigurtë, komunikativ dhe bashkëpunues dhe në këtë kontekst dëshiroj t'i falënderoj të gjitha Drejtoritë e Administratës së Komunës të cilat kanë ndihmuar në ofrimin e ndihmave të mundshme.

Sipas Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi i ngritë të gjitha komitetet dhe njëherit i zgjedh edhe kryesuesit e atyre komiteteve, përveç Komitetit për Komunitete të cilin, si pak më parë, e zgjedh vet kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin.

Pati mospajtime lidhur me zgjedhjen e kryesuesit të këtij Komiteti, unë jam thellësisht i bindur se edhe propozimet edhe votimi ishin transparente dhe demokratike, mirëpo përkundër kësaj duhet ta kemi të qartë se kryesuesi i Komitetit është i barabartë me anëtarët tjerë, mirëpo ai e ka një barrë më tepër në organizimin dhe udhëheqjen e mbledhjeve por edhe angazhime dhe kontakte me struktura të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Në rendin e ditës është edhe ngritja e Komisionit për hartimin e Planit të punës, lidhur me këtë mund të them se Plani i punës është mjaftë i rëndësishëm por përveç miratimit të këtij plani duhet edhe angazhim për zbatimin e të njëjtit.

Komiteti për Komunitete i komunës së Podujevës, deri tash, ka qenë shembull për punën, angazhimin e në veçanti për unitetin dhe respektin e ndërsjellë të anëtarëve të vet, andaj ju bëjë thirrje të angazhohemi në zgjidhjen e kërkesave dhe brengave të komuniteteve dhe të lëmë anash shprehjen e pakënaqësive.

Konsideroj se nuk ekziston asnjë arsye për dorëheqje nga cilësia e anëtarit të këtij Komiteti dhe nuk pajtohem me mënyrën dhe arsyet për paraqitje të dorëheqjes, andaj edhe një herë ju ftoj për komunikim të mirëfilltë dhe konsideratë ndaj njëri tjetrit, që deri tash ka qenë evidente, dhe jam i bindur se në këtë mënyrë do të vazhdohet edhe në të ardhmen.

z. Bahri Selimi, theksoi, gjatë diskutimeve u theksua se ky Komitet nuk ka punuar aq sa është dashur, lidhur me këtë jam i mendimit se barra e mospunës nuk bie vetën në një person, qoftë ai edhe kryesuesi, por barra bie mbi gjithë anëtarët e Komitetit.

Sa i përket mospajtimeve lidhur me zgjedhjen e kryesuesit mund të them se propozimet u paraqiten në mënyrë transparente dhe votimi ishte demokratik, andaj të gjithë duhet ta kemi të qartë se në demokraci vendos shumica, ashtu siç vendosi pak më parë për zgjedhjen e kryesuesit të këtij Komiteti. **z. Xhafer Ademi** theksoi se komuniteti i tij kërkon që të jep dorëheqje, për këtë nuk dha sqarime, por kjo nënkupton se ai nuk ka punuar mirë dhe për këtë ka përgjegjësi.

z. Xhafer Ademi, theksoi, në diskutimin paraprak e cekta se partinë e kemi formuar me një qëllim që të bëjmë ndryshime, andaj nuk mundem me tradhtuar komunitetin tim.

z. Mefail Rama, theksoi, në diskutimin e mëparshëm nuk thash se nuk është punuar, por vërejtja ime ka të bëjë me **z. Shaban Ahmetin**, që edhe në mandatin e kaluar ka qenë kryesues i këtij Komiteti e i cili nuk i ka përfillur kërkesat e pjesëtarëve të komunitetit tim e në veçanti ato për arsim.

Mirëpo me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim kemi pasur bashkëpunim të mirë dhe jam i kënaqur me punën që kemi bërë. Po ashtu jam i kënaqur edhe Drejtoritë e Komunës të cilat i kanë mbështetur të gjitha kërkesat tona.

z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit, parafolësit iu përgjigj, edhe më parë keni qenë anëtar i këtij Komiteti dhe dëshmitar se të gjitha kërkesat se të gjitha janë shqyrtuar në mbledhje të Komitetit dhe me rekomandime u janë adresuar Drejtorive kompetente.

z. Shaban Osmani, theksoi, Kuvendi i Komunës në bazë të propozimeve të komuniteteve përkatëse dhe propozimeve të subjekteve politike, në mënyrë transparente dhe demokratike e ka themeluar Komitetin për Komunitete, po ashtu në mënyrë demokratike, me 5 vota për dhe 2 vota kundër, u zgjedh kryesuesi i këtij Komiteti, dy anëtarë i paraqitën dorëheqjet është çështje personale e tyre, mirëpo është në vullnetin e çdonjërit se a dëshiron apo nuk dëshiron të jetë anëtar i këtij Komiteti, ata insistuan që të bëhen ndryshime, andaj do të ishte mirë që në vend të tyre të propozojnë kandidatët të cilët vërtet e meritojnë të jenë anëtarë të këtij Komiteti.

z. Xhafer Ademi, theksoi, arsyet e dorëheqjes sime i përmenda dhe po e përsërisë dorëheqja ime është definitive dhe e përvokueshme.

3. Ngritja e Komisionit për hartimin e Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2014

Pas propozimeve të bëra dhe votimit u konstatua se Komisioni për hartimin e propozimit të Planit të punës, njëzëri u ngritë në këtë përbërje:

1. Bahri Selimi, kryesues
2. Radisav Perović, dhe
3. Mefail Rama, anëtar

4. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.35'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01-006-29915
Podujevë,
19 mars 2014**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**